



Manuali I Përdorimit dhe Mirëmbajtjes

**Product Link - PL121, PL321, PL522 dhe
PL523**

Informacion i rëndësishëm për sigurinë

Shumica e aksidenteve që përfshijnë përdorimin e makinerisë, mirëmbajtjen dhe riparimet shkaktohen nga neglizhenca e ndjekjes së masave paraprake ose të rregullave bazë të sigurisë. Shpesh një aksident mund të mënjanohet nga njohja e situatave të mundshme të rrezikshme përpara se të ndodhë aksidenti. Personat duhet të jenë vigjilentë ndaj rreziqeve të mundshme, përfshirë faktorët njerëzorë që mund të rrezikojnë sigurinë. Gjithashtu, ky person duhet të ketë trajnimin, aftësitë dhe mjetet e nevojshme për t'i kryer si duhet këto funksione.

Përdorimi, lubrifikimi, mirëmbajtja ose riparimi i pasaktë i këtij produkti mund të jetë i rrezikshëm dhe mund të rezultojë në plagosje ose vdekje.

Mos e përdorni ose mos kryeni asnjë lubrifikim, mirëmbajtje ose riparim të këtij produkti derisa të verifikoni se jeni të autorizuar ta kryeni këtë punë dhe pasi të keni lexuar dhe kuptuar informacionet e përdorimit, lubrifikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit.

Masat paraprake dhe paralajmërimet e sigurisë jepen në këtë manual dhe në produkt. Nëse këto paralajmërimet rreziqesh nuk ndiqen, mund të ndodhin lëndime trupore ose vdekje për ju ose personat e tjerë.

Rreziqet identifikohen nga simboli i sigurisë dhe ndiqen nga një fjalë sinjalizuese, si për shembull RREZIK, PARALAJMËRIM ose KUJDES. Etiketa PARALAJMËRIM e simbolit të sigurisë paraqitet më poshtë.



WARNING

Domethënia e këtij simboli sigurie është:

Bëni kujdes! Jini të vëmendshëm! Bëhet fjalë për sigurinë tuaj.

Mesazhi që shfaqet nën paralajmërim shpjegon rrezikun, ose me një mesazh të shkruar, ose me një vizatim.

Një listë jo e plotë e të gjitha përdorimeve që mund të shkaktojnë dëmtimin e produktit identifikohen nga shenjat "NJOFTIM", të cilat mund të gjenden në produkt dhe në këtë manual.

Caterpillar nuk mund të parashikojë çdo rrethanë të mundshme që mund të përfshijë një rrezik të mundshëm. Si rrjedhojë, paralajmërimet në këtë manual dhe në produkt mund të mos jenë përfshirë të gjitha. Ju nuk duhet ta përdorni këtë makineri në ndonjë mënyrë të ndryshme nga ajo e treguar në këtë manual pa u siguruar më parë se ju i keni marrë në konsideratë të gjitha rregullat e sigurisë dhe masat paraprake që lidhen me përdorimin e produktit në vendin e përdorimit, duke përfshirë rregullat specifike dhe masat paraprake që aplikohen për vendin e punës. Nëse përdoret një vegël, një procedurë pune ose teknikë përdorimi që nuk rekomandohet në mënyrë specifike nga Caterpillar, atëherë ju duhet të siguroheni që ajo është e sigurt për ju dhe për të tjerët. Duhet të siguroheni gjithashtu që jeni i autorizuar ta kryeni këtë punë dhe se produkti nuk do të dëmtohet ose do të bëhet i pasigurt nga procedurat e përdorimit, lubrifikimit, mirëmbajtjes ose riparimit që mendoni të përdorni.

Informacioni, specifikimet dhe ilustrimet në këtë manual janë të bazuara në informacionin që ishte i disponueshëm në kohën kur është shkruar ky manual. Të dhënat mbi specifikimet, shtrëngimet, presionet, përmasat, rregullimet, ilustrimet dhe çdo zë tjetër mund të ndryshojnë në çdo kohë. Këto ndryshime mund të ndikojnë shërbimin që i bëhet produktit. Merrni informacionin e plotë dhe më aktual përpara se të filloni ndonjë punë. Shitësit e Cat disponojnë informacionin më aktual.



PARALAJMËRIM

Nëse kërkohen pjesë ndërrimi për këtë produkt, Caterpillar rekomandon përdorimin e pjesëve të ndërrimit Cat.

Mosndjekja e këtij paralajmërimi mund të sjellë defekte të parakohshme, dëmtimin e produktit, si dhe mund të shkaktojë lëndim personi ose vdekje.

Në Shtetet e Bashkuara, mirëmbajtja, zëvendësimi ose riparimi i pajisjeve dhe i sistemeve të kontrollit të emetimeve mund të kryhen nga një oficinë riparimesh ose nga një individ që zgjidhet nga drejtuesi.

Përmbajtja

Parathënie 4

Sektori i sigurisë vetjake

Shenjat dhe etiketat e sigurisë vetjake 5

Të dhëna të përgjithshme mbi rreziqet..... 6

Informacion i përputhjes me rregullat

Komponentët e radiofrekuencës 7

Seksioni i përdorimit

Përdorimi 13

Sektori i Indeksit

Indeksi 15

Parathënie

Informacion mbi Manualin

Ky manual duhet të ruhet në vendin e posaçëm për literaturën e makinerisë.

Ky manual përmban informacione mbi sigurinë vetjake, përdorimin dhe mirëmbajtjen.

Disa nga ilustrimet ose fotografitë mund të tregojnë detaje ose pjesë të ndryshme nga ato të makinerisë suaj.

Përmirësim i vazhdueshëm dhe projektim i avancuar mund të ketë shkaktuar ndryshime në makinerinë tuaj që nuk janë përfshirë në këtë manual. Lexo, studio dhe mba këtë manual me makinerinë.

Nëse lindin pyetje mbi përdorimin e makinerisë ose mbi këtë manual, ju lutemi të konsultoni shitësin e Cat për informacionet më të fundit.

Siguria Vetjake

Sektori i Sigurisë Vetjake rradhit përkujdesjet themelore. Për më tepër, ky sektor identifikon tekstin dhe vendndodhjen e shenjave të rrezikut si dhe të etiketave të vendosura mbi makineri.

Përdorimi

Sektori i përdorimit është mjet referimi për drejtuesin pa eksperiencë dhe rifreskues aftësish për drejtuesin me eksperiencë. Ky sektor përfshin një diskutim mbi matësit, celësat, pultet e komandimit të makinerisë dhe pjesëve bashkëngjyëse si dhe programimin e makinerisë.

Fotografitë dhe ilustrimet udhëzojnë drejtuesin në procedurat e duhura të kontrollit, ndezjes, përdorimit dhe ndalimit të makinerisë.

Teknikat e drejtimit të përmbledhura në këtë manual janë elementare. Aftësia dhe teknika zhvillohet ndërsa drejtuesi fiton njohuri mbi makinerinë dhe aftësitë e saj.

Mirëmbajtja

Sektori i mirëmbajtjes është një udhëzim mbi kujdesin që duhet treguar ndaj makinerisë.

Sektori i sigurisë vetjake

i07743657

Shenjat dhe etiketat e sigurisë vetjake

Kodi SMCS: 7606



PARALAJMERIM

Mos punoni me këtë makineri përpara se të keni lexuar dhe kuptuar udhëzimet dhe paralajmërimet në Manualin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes. Mosndjekja e udhëzimeve ose mungesa e vëmendjes ndaj paralajmërimeve mund të sjellë lëndim ose vdekje. Kontaktoni shitësin tuaj të Caterpillar për manuale zëvendësuese. . Kujdesi i duhur është përgjegjësia juaj.

Mesazhet e sigurisë

Etiketa e paralajmërimit në figurën 1 mund të gjendet në vende të tilla si kruskoti. Etiketa e paralajmërimit do të shfaqet qartë për drejtuesin gjatë përdorimit normal të makinerisë.




Figura 1
Etiketa

g01370917



PARALAJMERIM

Kjo makineri është e pajisur me një pajisje komunikimi Product Link të Caterpillar. Kur përdoren detonatorë elektrikë, kjo pajisje komunikimi duhet të çaktivizohet brenda 12 m (40 ft) nga vendi i shpërthimit ose brenda distancës zyrtare në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore. Moszbatimi i kësaj mund të shkaktojë interferencë me operacionet e shpërthimit dhe të shkaktojë lëndim serioz ose vdekje.

Zona e shpërthimit përkufizohet si zonë ku trajtohen materiale shpërthyes gjatë ngarkimit. Në të përfshihet dhe perimetri i formuar nga vrimat e ngarkuara të shpërthimit.

Nëse makineria kërkohet që të punojë brenda ose pranë një zone shpërthimi, atëherë drejtuesi duhet ta çaktivizojë Product Link. Pra duhet të çaktivizohet, ose sistemi PL121, ose PL522 / PL523. Një nga metodat e mëposhtme sugjerohet për të çaktivizuar sistemin PL121 ose PL522 / PL523:

- Vendosni një çelës shkëputjeje të Product Link te kabina e makinerisë. Ky çelës do të lejojë kalimin e modulit të sistemit PL121 ose PL522 / PL523 në OFF (fikur). Referojuni Udhëzimit special, REHS2365, Udhëzuesi i instalimit për Product Link PL121 dhe PL321 ose Udhëzimit special, REHS2368, Procedura e instalimit të Product Link PL522 dhe PL523 (celular) për më shumë hollësi dhe udhëzime instalimi.
- Ndërkohë që çelësi i zonës së shpërthimit është në pozicion OFF (fikur), sistemi PL121 ose PL522 / PL523 nuk do të ndjekin më orët e njësisë matëse të shërbimit (SMU) ose të dhënat VIMS. Rregullimi i orëve të matësit të shërbimit (SMH) do të kërkohet pas rikthimit të energjisë në sistemin Product Link. Konsultohuni me shitësin tuaj të Caterpillar nëse keni ndonjë pyetje.
- Shkëputni modulin e sistemit PL121 ose PL522 / PL523 nga burimi kryesor i energjisë. Ky veprim kryhet duke shkëputur grupin e telave në modulin Product Link.

Etiketa të tjera

Etiketa në figurën 2 mund të gjendet në një vend lehtësisht të dukshëm. Vendi lehtësisht i dukshëm gjatë përdorimit normal të makinerisë përshkruhet si kruskot.



Figura 2

g01787075

Etiketa në ilustrimin 2 synon që të informojë drejtuesin që makineria është e pajisur me një pajisje transmetimi me valë. Të dhënat, gjendja dhe përdorimi i makinerisë do të transmetohen nga pajisja Product Link. Informacioni i transmetohet Caterpillar dhe/ose shitësve të Caterpillar për t'i shërbyer më mirë klientit dhe për të përmirësuar produktet dhe shërbimet e Caterpillar. Transmetimi i informacionit nëpërmjet pajisjeve Product Link i nënshtrohet kërkesave ligjore që mund të ndryshojnë nga njëra vendndodhje në tjetrën.

Referojuni Manualit të përdorimit dhe mirëmbajtjes, SEBU8142, Përdorimi dhe Manualit të përdorimit dhe mirëmbajtjes, SEBU8142, Seksioni i pajtueshmërisë me rregulloret për informacione shtesë.

i07743656

Të dhëna të përgjithshme mbi rreziqet

Kodi SMCS: 7606



PARALAJMERIM

Mos punoni me këtë makineri përpara se të keni lexuar dhe kuptuar udhëzimet dhe paralajmërimet në Manualin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes. Mosndjekja e udhëzimeve ose mungesa e vëmendjes ndaj paralajmërimeve mund të sjellë lëndim ose vdekje. Kontaktoni shitësin tuaj të Caterpillar për manuale zëvendësuese. . Kujdesi i duhur është përgjegjësia juaj.

Parathënie

Ky dokument është një shtojcë e Manualit të përdorimit dhe mirëmbajtjes së makinerisë. Ngjiteni përgjithmonë këtë dokument te Manuali i përdorimit dhe mirëmbajtjes së makinerisë.

Hyrje

Ky dokument ofron informacion rreth përdorimit të sa më poshtë:

- Sistemet Product Link PL121 / PL321
- Sistemet Product Link PL522 / PL523

Përdorimi dhe mirëmbajtja e makinerisë nuk duhet të ndodhë, nëse lexohen dhe kuptohen udhëzimet dhe paralajmërimet në Manualin e përdorimit dhe mirëmbajtjes. Përmbajtja e këtij dokumenti duhet të kuptohet përpara për makinerinë e pajisur me sa më poshtë:

- Sistemet Product Link PL121 / PL321
- Sistemet Product Link PL522 / PL523

Informacion i përputhjes me rregullat

Komponentët e radiofrekuencës

i07743655

Product Link (PL522 and PL523 - Nëse ka)

Kodi SMCS: 7490; 7606

S/N: PL51–e lart

NJOFTIM

Transmetimi i informacionit përmes pajisjes së komunikimit Produkt Link të Cat u nënshtrohet kërkesave ligjore. Kërkesat ligjore mund të ndryshojnë nga vendi në vend, përfshirë, por pa u kufizuar te autorizimi i përdorimit të radiofrekuencës. Përdorimi i pajisjes së komunikimit Product Link të Cat duhet të kufizohet për vendet ku plotësohen të gjitha kërkesat ligjore për përdorimin e pajisjes dhe rrjetit të komunikimit Product Link të Cat.

Nëse pajisja që vjen me pajisjen e komunikimit Product Link të Cat gjendet ose vendoset në një vendndodhje ku (i) nuk plotësohen kërkesat ligjore ose (ii) transmetimi ose përpunimi i këtij informacioni në vendndodhje të ndryshme nuk është i ligjshëm, Caterpillar heq dorë nga çdo përgjegjësi që lidhet me këtë mospajtim dhe Caterpillar mund të mos e vazhdojë transmetimin e informacionit nga ajo pajisje.

Konsultohuni me shitësin e Cat për çdo pyetje në lidhje me përdorimin e sistemit Product Link në një shtet të caktuar.

Referencë: Referojuni Manualit të përdorimit dhe të mirëmbajtjes të produktit tuaj për informacion shtesë.

Specifikimet



PARALAJMERIM

Kjo pajisje ka një pajisje komunikimi Product Link të Cat®. Kur përdoren detonatorë elektrikë për shpërthime, pajisjet me radiofrekuenca mund të shkaktojnë interferencë me detonatorët elektrike për shpërthime, gjë e cila mund të shkaktojë plagosje të rëndë ose vdekje. Pajisja e komunikimit Product Link duhet të çaktivizohet brenda distancës së rregulluar sipas të gjitha kërkesave rregullatore kombëtare ose lokale në fuqi. Në mungesë të kërkesave rregullatore, Caterpillar rekomandon përdoruesin fundor që të kryejë individualisht vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar distancën e sigurt të punës.

Specifikimet e mëposhtme të pajisjes së komunikimit Product Link të Cat ofrohen për të ndihmuar në kryerjen e vlerësimit të rreziqeve dhe për të siguruar pajtueshmëri me të gjitha rregulloret vendore:

Tabela 1

Specifikimet e transmetuesit radio		
Modeli	Shkalla e frekuencës së transmetuesit	Fuqia e transmetuesit
PL522 dhe PL523	824 MHz - 849 MHz	0,5 W tipike 2 W maks.
	880 MHz - 915 MHz	
	1710 MHz - 1755 MHz	
	1850 MHz - 1910 MHz	

Tabela 2

Tensioni i përdorimit dhe tërheqja e rrymës		
Modeli	Diapazoni i tensionit	Diapazoni i tërheqjes maksimale të korrentit
PL522 dhe PL523	9–32V	850 mA-225 mA

Njoftim certifikimi

Njoftimi i Kanadasë për përdoruesit

Kjo pajisje pajtohet me licencën e "Industry Canada" e përjashtuar nga RSS-të. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- Kjo pajisje mund të mos shkaktojë ndërhyrje
- Kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje, përfshirë ato që mund të shkaktojnë përdorim të padëshiruar të pajisjes.

Njoftim nga FCC

Kjo pajisje pajtohet me pjesën 15 të rregullave të FCC. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- Kjo pajisje mund të mos shkaktojë ndërhyrje të dëmshme.
- Kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje hyrëse, përfshirë ato që mund të shkaktojnë përdorim të padëshiruar.

Kjo pajisje është testuar dhe konstatuar të pajtohet me pjesën 22 dhe 24 të FCC, si dhe me kufizimet për pajisjen dixhitale të kategorisë B, në përputhje me pjesën 15 të rregullave të FCC. Këto kufizime janë krijuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme për instalimet e kryera në banesa. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të radiofrekuencës dhe nëse nuk instalohet dhe nëse nuk përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme në komunikimet në radio. Megjithatë, nuk ka garanci që ndërhyrja të mos ndodhë në një instalim të caktuar. Nëse pajisja shkakton ndërhyrje të dëmshme në marrjen e sinjalit të radios ose televizorit, e cila mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi këshillohet të përpiqet të rregullojë ndërhyrjen duke marrë parasysh një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Të riorientojë ose të zhvendosë antenën marrëse të sinjalit
- Të rrisë distancën ndërmjet pajisjes dhe marrësit
- Të vendosë pajisjen në një prizë ose qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi
- Të konsultohet me shitësin ose me një teknik radio/televiziv me përvojë për ndihmë

Ndryshimet ose modifikimet e pajisjes pa miratimin e shprehur të Caterpillar, mund të sjellin anulimin e autoritetit të përdoruesve për përdorimin e pajisjes.

Deklarata e konformitetit - Bashkimi Evropian

Tabela 3

CATERPILLAR®

Deklarata e konformitetit e BE-së

Deklarata e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.

I nënshkruari, përfaqësues i prodhuesit:

CATERPILLAR INC

100 N.E. Adams Street

Peoria, IL 61629

SHBA

nëpërmjet këtij dokumenti, deklaron se produkti, objekti i këtij përshkrimi:

Pajisje telematike radio celulare 500 Radio Product,

Marka: Caterpillar Modeli: 500 Radio Product (Cat 522 dhe Cat 523)

Pjesa numër 346-9376 e antenës Numri i pjesës: 351 - 8490 dhe 351 - 8492

Janë në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së për harmonizimin:

Direktiva 2014/53/BE

Direktiva 2011/65/BE

Konformiteti tregohet përmes përputhjes së kërkesave të zbatueshme të dokumenteve të mëposhtme:

Procedura e vlerësimit të konformitetit: ☒ X shtoja II, ☐ shtoja III, ☐ shtoja IV

2014/53/BE:	LVD (Seksioni 3.1a):	EN60950-1:2006+A11:2009+A1:2010+A12:2011 +A2:2013
		EN 62311:2008
	EMC (Seksioni 3.1b):	EN 301 489-1 V2.2.0
		EN 301 489-3 V2.1.1
		EN 301 489-19 V2.1.0
2011/65/BE:	RF (Seksioni 3.2)	EN 301 489-52 V1.1.0
		EN 301 511 V12.5.1
	RoHS	EN 300 440 V2.1.1
		EN 50581:2012

Signature: *Michael Caruthers*Name: *Michael Caruthers*Title: *Engineering Manager*Place: *Peoria, IL*Date: *7 Sept 2017*

i07743659

Product Link (PL121 - Nëse ka)

Kodi SMCS: 7490; 7606

S/N: PL11—e lart

NJOFTIM

Transmetimi i informacionit përmes pajisjes së komunikimit Produkt Link të Cat u nënshtrohet kërkesave ligjore. Kërkesat ligjore mund të ndryshojnë nga vendi në vend, përfshirë, por pa u kufizuar te autorizimi i përdorimit të radiofrekuencës. Përdorimi i pajisjes së komunikimit Produkt Link të Cat duhet të kufizohet për vendet ku plotësohen të gjitha kërkesat ligjore për përdorimin e pajisjes dhe rrjetit të komunikimit Produkt Link të Cat.

Nëse pajisja që vjen me pajisjen e komunikimit Produkt Link të Cat gjendet ose vendoset në një vendndodhje ku (i) nuk plotësohen kërkesat ligjore ose (ii) transmetimi ose përpunimi i këtij informacioni në vendndodhje të ndryshme nuk është i ligjshëm, Caterpillar heq dorë nga çdo përgjegjësi që lidhet me këtë mospajtim dhe Caterpillar mund të mos e vazhdojë transmetimin e informacionit nga ajo pajisje.

Konsultohuni me shitësin e Cat për çdo pyetje në lidhje me përdorimin e sistemit Produkt Link në një shtet të caktuar.

Referencë: Referojuni Manualit të përdorimit dhe të mirëmbajtjes të produktit tuaj për informacion shtesë.

Specifikimet



PARALAJMERIM

Kjo pajisje ka një pajisje komunikimi Produkt Link të Cat®. Kur përdoren detonatorë elektrikë për shpërthime, pajisjet me radiofrekuencë mund të shkaktojnë interferencë me detonatorët elektrike për shpërthime, gjë e cila mund të shkaktojë plagosje të rëndë ose vdekje. Pajisja e komunikimit Produkt Link duhet të çaktivizohet brenda distancës së rregulluar sipas të gjitha kërkesave rregullatore kombëtare ose lokale në fuqi. Në mungesë të kërkesave rregullatore, Caterpillar rekomandon përdoruesin fundor që të kryejë individualisht vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar distancën e sigurt të punës.

Specifikimet e mëposhtme të pajisjes së komunikimit Produkt Link të Cat ofrohen për të ndihmuar në kryerjen e vlerësimit të rreziqeve dhe për të siguruar pajtueshmëri me të gjitha rregulloret vendore:

Tabela 4

Specifikimet e transmetuesit radio		
Modeli	Shkalla e frekuencës së transmetuesit	Fuqia e transmetuesit
PL121	148 MHz -150 MHz	5W tipike 10 W maks.

Njoftimet e certifikimit

Njoftimi i Kanadasë për përdoruesit

Njoftim i përditësuar i Industry Canada për pjesën e përdoruesve për sa më poshtë:

Kjo pajisje pajtohet me licencën e Industry Canada, përjashtuar RSS-të. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- Kjo pajisje mund të mos shkaktojë ndërhyrje
- Kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje, përfshirë ato që mund të shkaktojnë përdorim të padëshiruar të pajisjes.
- Ky transmetues radioje është miratuar nga Industry Canada për t'u përdorur me llojet e antenave të renditura më poshtë, me rritjen maksimale të lejuar që tregohet. Llojet e antenave që nuk përfshihen në këtë listë, që kanë një rritje më të madhe sesa ajo maksimale që tregohet për atë lloj, janë rreptësisht të ndaluara për t'u përdorur me këtë pajisje.
- Kjo pajisje është ndërtuar për t'u përdorur me antenën (antenat) e renditur më poshtë dhe ka një rritje maksimale prej 3 dBi. Antenat që nuk përfshihen në këtë listë ose që kanë një rritje më të madhe sesa 2, 14 dBi, janë rreptësisht të ndaluara për t'u përdorur me këtë pajisje. Rezistenca e kërkuar për antenën është 50 Ohm.

Antenat për përdorim:

- Antenë 351-8485 si montim i palëvizshëm

Njoftim nga FCC

Kjo pajisje pajtohet me pjesën 15 të rregullave të FCC. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- Kjo pajisje mund të mos shkaktojë ndërhyrje të dëmshme.
- Kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje hyrëse, përfshirë ato që mund të shkaktojnë përdorim të padëshiruar.

Kjo pajisje është testuar dhe konstatuar të pajtohet me kufizimet për pajisjen dixhitale të kategorisë B, në përputhje me pjesën 15 të rregullave të FCC. Këto kufizime janë krijuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme për instalimet e kryera në banesa. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të radiofrekuencës dhe nëse nuk instalohet dhe nëse nuk përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme në komunikimet në radio. Megjithatë, nuk ka garanci që ndërhyrja të mos ndodhë në një instalim të caktuar. Nëse pajisja shkakton ndërhyrje të dëmshme në marrjen e sinjalit të radios ose televizorit, e cila mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi këshillohet të përpiqet të rregullojë ndërhyrjen duke marrë parasysh një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Të riorientojë ose të zhvendosë antenën marrëse të sinjalit
- Të risë distancën ndërmjet pajisjes dhe marrësit
- Të vendosë pajisjen në një prizë ose qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi
- Të konsultohet me shitësin ose me një teknik radio/televiziv me përvojë për ndihmë

Ndryshimet ose modifikimet e pajisjes pa miratimin e shprehur të Caterpillar, mund të sjellin anulimin e autoritetit të përdoruesve për përdorimin e pajisjes.

Deklarata e konformitetit - Bashkimi Evropian

Tabela 5

CATERPILLAR®

Deklarata e konformitetit e BE-së

Deklarata e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.

I nënshkruari, përfaqësues i prodhuesit:

CATERPILLAR INC

100 N.E. Adams Street

Peoria, IL 61629

309-578-9220

SHBA

nëpërmjet këtij dokumenti, deklarohet se produkti, objekti i këtij përshkrimi:

Product Link, PL121, pajisje telematike radiosatelitore

Marka: Caterpillar

Modeli: PL121

Numri i pjesës: 336-3545

Pjesa #: 351-8485 e antenës

Është në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së për harmonizimin:

Direktiva 2014/53/BE

Direktiva 2011/65/BE

Konformiteti tregohet përmes përputhjes së kërkesave të zbatueshme të dokumenteve të mëposhtme:

Procedura e vlerësimit të konformitetit: ☒ X shtoja II, ☐ shtoja III, ☐ shtoja IV

2014/53/BE:	LVD (Seksioni 3.1a):	EN60950-1:2006 + A11:2009+ A1:2010 + A12:2011 + A2:2013 EN 62311:2008
	EMC (Seksioni 3.1b):	EN 301 489-1 V2.1.1 EN 301 489-19 V2.1.0 EN 301 489-20 V2.1.0
	RF (Seksioni 3.2)	EN 301 721 V2.1.1 EN 303 413 V1.1.1
2011/65/BE:	RoHS	EN 50581:2012

Signature:



Name: Saul Boast

Place: Mossville, IL

Title: Engineering Manager

Date: 29Mar2019

Seksioni i përdorimit

Përdorimi

i07743653

Product Link

Kodi SMCS: 7606

Shënim: Makineria juaj mund të jetë e pajisur me sistemin Product Link™ të Cat®.

Pajisja e komunikimit Product Link e Cat shfrytëzon teknologjinë celulare dhe/ose satelitore për të transmetuar informacion për pajisjen. Ky informacion i komunikohet Caterpillar, shitësve të Cat dhe klientëve të Caterpillar. Pajisja e komunikimit Product Link e Cat përdor marrës satelitorë të Sistemit të Pozicionimit Global (GPS).

Mundësia e komunikimit të dyanshëm mes pajisjes dhe një përdoruesi në distancë mundësohet me pajisjen e komunikimit Product Link të Cat. Përdoruesi në distancë mund të jetë një shitës ose një klient.

Transmetimet e të dhënave

Të dhënat që i përkasin kësaj makinerie, gjendjes së makinerisë dhe përdorimit transmetohen nga Product Link i Cat të Caterpillar dhe/ose shitësit e Cat. Të dhënat përdoren për t'i shërbyer më mirë konsumatorit dhe për përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të Cat. Informacioni i transmetuar mund të përfshijë: numrin e serisë së makinerisë, vendndodhjen e makinerisë dhe të dhënat e punës, përfshi, por pa u kufizuar te: kodet e defekteve, të dhënat e emetimeve, përdorimin e karburantit, orët e matësit të shërbimit, numrat e versioneve të softuerit dhe harduerit dhe pjesët shtesë të montuara.

Caterpillar dhe/ose shitësit e Cat mund ta përdorin këtë informacion për qëllime të ndryshme. Referojuni listës së mëposhtme për përdorimet e mundshme:

- Për të ofruar shërbime për klientët dhe/ose makinerinë
- Kontrolli ose mirëmbajtja e pajisjes Product Link të Cat
- Për të monitoruar mbarëvajtjen e makinerisë ose performancën
- Për të ndihmuar në mirëmbajtjen e makinerisë dhe/ose në përmirësimin e efikasitetit të makinerisë
- Për të vlerësuar ose për të përmirësuar produktet dhe shërbimet e Cat

- Për t'u pajtuar me kërkesat ligjore dhe me urdhrat e vlefshëm gjyqësorë
- Për të kryer studim të tregut
- Për t'iu ofruar klientëve produkte dhe shërbime të reja

Caterpillar mund të ndajë një pjesë ose të gjithë informacionin e mbledhur me kompanitë bashkëpunëtoresh, me shitësit dhe përfaqësuesit e autorizuar të Caterpillar. Caterpillar nuk do ta shesë dhe as do ta huazojë informacionin e mbledhur me asnjë palë të tretë dhe do të kryejë përpjekje të arsyeshme për ta mbajtur të sigurt këtë informacion. Caterpillar njeh dhe respekton fshehtësinë e klientit. Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni shitësin tuaj lokal të Cat.

Përdorimi i radiove me Product Link në zona shpërthimi



PARALAJMERIM

Kjo pajisje ka një pajisje komunikimi Product Link të Cat®. Kur përdoren detonatorë elektrikë për shpërthime, pajisjet me radiofrekuenca mund të shkaktojnë interferencë me detonatorët elektrike për shpërthime, gjë e cila mund të shkaktojë plagosje të rëndë ose vdekje. Pajisja e komunikimit Product Link duhet të çaktivizohet brenda distancës së rregulluar sipas të gjitha kërkesave rregullatore kombëtare ose lokale në fuqi. Në mungesë të kërkesave rregullatore, Caterpillar rekomandon përdoruesin fundor që të kryejë individualisht vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar distancën e sigurt të punës.

Referojuni Suplementit të manualit të përdorimit dhe mirëmbajtjes, Informacioni rregullator i pajtueshmërisë të produktit tuaj për më shumë informacion.

Për informacion në lidhje me metodat për të çaktivizuar pajisjen e komunikimit Product Link të Cat, ju lutemi t'i referoheni manualit të Product Link të Cat, i cili renditet më poshtë:

- Manuali i përdorimit dhe mirëmbajtjes, SEBU8142, Product Link - PL121, PL321, PL522 dhe PL523
- Manuali i përdorimit dhe mirëmbajtjes, SEBU8832, Product Link sistemet PLE702, PLE602, PLE601, PL641, PL631, PL542, PL240, PL241, PL141, PL131, PL161 dhe PL042

Shënim: Nëse nuk është vendosur asnjë çelës për çaktivizimin e radios dhe pajisja do të përdoret pranë një zone shpërthimi, në pajisje duhet të vendoset një çelës çaktivizimi për radion Product Link. Çelësi do të lejojë fikjen e pajisjes së komunikimit Product Link të Cat nga drejtuesi, nëpërmjet panelit të kontrollit të pajisjeve. Për më shumë hollësi dhe procedura instalimi, referojuni si më poshtë:

- Udhëzimi special, REHS7339, Procedura e instalimit të sistemeve Product Link PLE640
- Udhëzimi special, REHS8850, Procedura e instalimit të sistemeve Elite Product Link PLE601, PLE641 dhe PLE631
- Udhëzimi special, SEHS0377, Procedura e instalimit të sistemeve Product Link PL131, PL141 dhe PL161
- Udhëzimi special, REHS9111, Procedura e instalimit të sistemeve Pro Product Link PL641 dhe PL631

Indeksi

Informacion i përputhjes me rregullat.....	7
Informacion i rëndësishëm për sigurinë	2
Komponentët e radiofrekuencës	7
Parathënie	4
Informacion mbi Manualin	4
Mirëmbajtja	4
Përdorimi	4
Siguria Vetjake	4
Përdorimi	13
Përmbajtja	3
Product Link	13
Përdorimi i radiove me Product Link në zona shpërthimi	13
Transmetimet e të dhënave	13
Product Link (PL121 - Nëse ka)	10
Deklarata e konformitetit - Bashkimi Evropian	12
Njoftimet e certifikimit	10
Specifikimet	10
Product Link (PL522 and PL523 - Nëse ka).....	7
Deklarata e konformitetit - Bashkimi Evropian	9
Njoftim certifikimi.....	7
Specifikimet	7
Seksioni i përdorimit	13
Sektori i sigurisë vetjake.....	5
Shenjat dhe etiketat e sigurisë vetjake.....	5
Etiketa të tjera	5
Mesazhet e sigurisë	5
Të dhëna të përgjithshme mbi rreziqet.....	6
Hyrje.....	6
Parathënie	6

Informacion mbi Makinerinë dhe Shitësin

Shënim: Për vendndodhjen e tabelave identifikuese të produktit shikoni sektorin "Informacione mbi Identifikimin e Produktit" në Manualin e Përdorimit dhe Mirëmbajtjes.

Data e Dorëzimit: _____

Informacion mbi Produktin

Modeli: _____

Numri Identifikues i Produktit: _____

Numri Serial i Motorrit: _____

Numri Serial i Kambios: _____

Numri Serial i Gjeneratorit: _____

Numrat Serialë të Shtesave: _____

Informacione mbi Shtesat: _____

Numri i Makinerisë së Klientit: _____

Numri i Makinerisë së Shitësit: _____

Informacione mbi Shitësin

Emri: _____ Dega: _____

Adresa: _____

Kontakti i Shitësit

Numri i Telefonit

Orët

Shitjet: _____

Pjesët e
Këmbimit: _____

Shërbimi: _____



S9BK8142
©2019 Caterpillar
Të Gjitha të Drejtat të
Rezervuara

Cat, Caterpillar, logot e tyre përkatëse, veshjet tregtare "Caterpillar Yellow" dhe "Power Edge", si dhe identiteti i korporatës dhe produktit që përdoret këtu, janë marka të Caterpillar dhe nuk mund të përdoren pa leje.